



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
THE MUNICIPALITY SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në pajtim me nenin 7, 8 dhe 9 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve Nr- 02 / L – 37, të nenit 9 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr- 03/L - 040 dhe të nenit 13 të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datë 11.11.2008 Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më datën 29.12.2008 miratoi këtë :

RREGULLOREN
PËR
PËRDORIMIN E GJUHËVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1.

Kjo Rregullore ka për qëllim që të rregullojë përdorimin e gjuhëve zyrtare në pajtim me dispozitat e Ligjit për përdorimin e gjuhëve nr. 02/L – 37, në punën e organeve komunale, institucionet arsimore, shëndetësore dhe ndërmarrjeve publike komunale, që qeverisen nga Komuna .

Neni 2.

Gjuha shqipe dhe gjuha serbe, si gjuhë zyrtare në Kosovë, janë të barabarta sa i përket përdorimit të tyre në të gjitha organet e administratës komunale, institucionet arsimore, shëndetësore dhe ndërmarrjet publike të Komunës së Suharekës.

II. PËRDORIMI I GJUHËVE

Përdorimi i gjuhëve në takime zyrtare, në tubime publike, në mbledhje të Kuvendit të Komunës

Neni 3.

3.1 Gjuhët zyrtare përdoren në baza të barabarta në takimet me qytetarë, në punën e organeve të administratës, në kolegjiunin e drejtorëve, në komitetet e përhershme dhe në komitetet tjera, si dhe në mbledhjet e Kuvendit të Komunës;

3.2 Sektori për punë të përgjithshme administrative në Drejtorinë e Administratës, do të mundësojë përkthimin nga një gjuhë zyrtare në tjetrën, nëse kjo kërkohet për takimet zyrtare, takimet publike, takimet e komiteteve dhe takimeve të tjera të organizuara nga Komuna;

3.3 Procesverbalet nga mbledhjet, e kuvendit dhe komiteteve, mbahen në gjuhët zyrtare.

3.4 Statuti i Komunës, Rregullorja e punës së Kuvendit, rregulloret komunale dhe vendimet që miratohen në Kuvendin e Komunës, shtypen në të dy gjuhët: në gjuhën shqipe dhe serbe.

Përdorimi i gjuhëve nga individët, institucionet, shoqëritë tregtare, organizatat etj

Neni 4.

4.1 Secili person i cili i drejtohet Organit të Komunës ,institucionit arsimor ,shëndetësor apo ndërmarrjes publike komunale, e ka të drejtën e përdorimit të gjuhës së tij , në të shkruar dhe në të folur.

4.2 Nocioni “gjuhë e palës”, ka kuptimin e gjuhës në të cilën pala fillimisht i është drejtuar Komunës.

Neni 5.

Komunikimi me komunat tjera të Kosovës, institucionet e Republikës së Kosovës, shoqëritë tregtare, organet dhe organizatat tjera mund të bëhen në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.

Përdorimi i gjuhëve në emërtimet zyrtare dhe shenjat zyrtare

Neni 6.

6.1 Emrat zyrtarë, të organeve komunale, të institucioneve arsimore , shëndetësore dhe ndërmarrjeve publike të Komunës së Suharekës, janë të shkruara në gjuhët zyrtare në përdorim në Kosovë.

6.2 Shenjat zyrtare që tregojnë emrat e fshatrave, të lagjeve, të rrugëve dhe të vendeve tjera publike, duhet të jenë të shkruara në të dy gjuhët: në gjuhën shqipe dhe serbe.

III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 7.

Kjo Rregullore mund të ndryshohet në procedurë të njëjtë me atë të miratimit.

Neni 8.

Në rast të mospajtimeve mes dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe Ligjit për përdorimin e gjuhëve, do të mbizotërojnë dispozitat e Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

Neni 9.

Pas miratimit në Kuvendin komunal, kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në Autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale.

KUVENDI I KOMUNËS - SUHAREKË

01-Nr-_____
Më datë _____

Kryesuesi i Kuvendit

Rexhep Kuçi